



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DËKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA
Republika e Kosovës / Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01
Nr./Br. M2102-37069
Data/Datum 01.10.2019
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Kuvendi i Komunës
01 Nr. _____
Datë: 27.09.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 7 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – Tabhanës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale, Tabhanës me numër të parcelës 02288-1 dhe 02288-2 si dhe të objekteve përcjellëse të cila janë në pronësi të Komunës së Gjakovës, me këtë përbërje :
 1. z. Flamur Fetahaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 2. z. Ferdinand Kola, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 3. z. Jusuf Osmani, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 4. z. Ali Tafarshiku, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 5. z. Idriz Daci, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi , për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

